



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1941/ 4 prot

Datë 01.11.2021

V E N D I M
Nr. 836/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.11.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “*O.E.S Distrimed*” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-97559-06-07-2021, me objekt “*Furnizim Vendorsje Aparatura Mjekësore, Mobilimi dhe Hotelerie për Godinën e Re të Pediatrisë, Ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore*”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër (në total për të gjitha lotet): 108,245,244.67 (njëqind e tetë milion e dyqind e dyzet e pesë mijë e dyqind dyzet e katër pikë gjashtëdhjetë e shtatë tridhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër presje pesë) Lekë pa TVSH, **Loti 2** me Nr. REF-97566-06-07-2021 me objekt “*Pajisje anestetike dhe të Frymëmarrjes*” me fond limit/vlerë të pritshme të kontratës 9,368,517.60 (nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*O.E.S Distrimed*” SHPK

Adresa: Blv “Bajram Curri”, Rruga “Nikollë Kacorri”, ND. 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 45 e vijues Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.06.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-97559-06-07-2021, me objekt “*Furnizim Vendorsje Aparatura Mjekësore, Mobilimi dhe Hotelerie për Godinën e Re të Pediatrisë, Ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore*”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër (në total për të gjitha lotet): 108,245,244.67 (njëqind e tetë milion e dyqind e dyzet e pesë mijë e dyqind dyzet e katër pikë gjashtëdhjetë e shtatë tridhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër presje pesë) Lekë pa TVSH, **Loti 2** me Nr. REF-97566-06-07-2021 me objekt “*Pajisje anestetike dhe të Frymëmarrjes*” me fond limit/vlerë të pritshme të kontratës 9,368,517.60 (nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.

II.2. Në datën 16.08.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 23.09.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Montal” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
2. “Biometric Albania” SHPK	5,870,000 lekë	skualifikuar
3. “Fedos” ShPK	7,500,000 lekë	skualifikuar
4. “O.E.S Distrimed” SHPK	8,017,100 lekë	skualifikuar

II.4. Më datë 23.09.2021 operatori ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyet si më poshtë vijon:

Për pajisjen Ventilator të Kujdesit Intensiv për Kirurgji Pediatrike dhe Neonate:

1. Ekran duhet të jetë me ekran me prekje me ngjyra LCD / TFT i integruar min 15 inç, mundësisht, të lundroni me një sëipe midis informacionit të së kaluarës, të tashmes dhe të së ardhmes (ekrani shtesë i veçantë / i shumëfishtë nuk do të jetë i pranueshëm).

Referuar katalogut të paraqitur nga OE në përmbushje të pikës d) tek 2.3 Kapaciteti Teknik, rezulton se pajisja e ofertuar nga OE ka ekran me prekje me ngjyra LCD / TFT i integruar 12,1 inc.

Për pajisjen aspirator:

1. Aspirator Neonat

2. Të jetë i përshtatshëm për infant

3. Të shoqërohet me të paktën 2 koka silikoni

Referuar katalogut të paraqitur nga OE në përmbushje të pikës d) tek 2.3 Kapaciteti Teknik si dhe Ofertës Teknike OE “OES Distrimed” shpk, rezulton se OE ka ofertuar modelin me nr 28215.

Për sa i përket aspiratorit me kod 28215 rezulton se tre specifikimet teknike të mësipërme nuk plotësohen pasi modeli i mësipërm i aspiratorit është i përshtatshëm për adult dhe pediatrike dhe jo për pacientët neonatale, sipas dokumentave të tenderit është kërkuar 1 pajisje aspirator për adulte dhe pediatrike i cili të ketë opsionin e përshtatjes për neonatale.

Mbështetur në nenin 92/3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se:

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendos të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “OES Distrimed” për arsye se ajo nuk përmbush specifikimet teknike sipas shtojcës 10 të DST, për specifikimet e mësipërme të kërkuar nga shërbimi.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave më datë 23.09.2021, si dhe më datë 07.10.2021 ka anuluar në sistem procedurën e prokurimit.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 12.10.2021 operatori ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1941/2 prot., datë 14.10.2021 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 2615/2 prot., datë 25.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1941/3 prot., datë 28.10.2021 me objekt “Kthim-përgjigje mbi Formularin e Ankesës të administruar pranë Autoritetit Kontraktor me Nr. 2615 prot., datë 13.10.2021 nga OE “O.E.S Distrimed” SHPK, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK dhe me shkresën nr. 2615/2 prot., datë 25.10.2021, e ka njoftuar operatorët ekonomik të interesuar si dhe ankimuesin se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, konkretisht citoj:

“[...]Pasi u vlerësua se operatori ka respektuar rregullat e mësipërme të parashikuara nga ligjvënësi dhe rrjedhimisht ankesa u mor në shqyrtim nga KSHA.

Lidhur me pretendimet për pajisjen: Ventilator të Kujdesit Intensiv për Kiiurgji Pediatrike dhe Neonate për specifikimin: Ekran duhet të jetë me ekran me prekje me ngjyra LCD / TFT i integruar min 15 inç, mundësisht, të lundroni me një sëipe midis informacionit të së kaluarës, të tashmes dhe të së ardhmes (ekrani shtesë i vecantë / i shumëfishtë nuk do të jetë i pranueshëm), KSHA sqaron se bazuar në shtojcën e ngarkuar në SPE në datë 30.07.2021 si më poshtë:

ISHTE: Ekran duhet të jetë me ekran me prekje me ngjyra LCD / TFT i integruar min 15 inç, mundësisht, të lundroni me një swipe midis informacionit të së kaluarës, të tashmes dhe të së ardhmes (ekrani shtesë i vepantë / i shumëfishtë nuk do të jetë i pranueshëm).

BËHET: Ekran duhet të jetë me ekran me prekje me ngjyra LCD / TFT i integruar min 12- 15 inç, mundësisht, të lundroni me një swipe midis informacionit të së kaluarës, të tashmes dhe të së ardhmes (ekrani shtesë i vecantë / i shumëfishtë nuk do të jetë i pranueshëm).

gjithashtu, referuar katalogut për artikullin nr. 2 të paraqitur nga OE me produktin “neumovent advance”, në faqen 3, për specifikimin: Screen “size: 12.1”, pretendimi i OE “OES DISTRIMED” shpk qëndron.

Pasi u vlerësua se operatori ka respektuar rregullat e mësipërme të parashikuara nga ligjvënësi dhe rrjedhimisht ankesa u mor në shqyrtim nga KSHA.

Lidhur me pretendimet për pajisjen: Aspirator për specifikimin “Aspirator Neonat, Të jetë i përshtatshëm për infant, Të shoqërohet me të paktën 2 koka silikoni”.... KSHA sqaron se pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet e OE, lidhur me vendimin e KVO për skualifikim të këtij OE, pasi nuk plotëson specifikimet teknike, të sipërcituara, dhe pas verifikimit të dokumentacionit teknik vëren se:

Për artikullin “Aspirator”, prodhues GIMA, modeli 28215, KSHA shqyrton, se katalogu i vënë në dispozicion në SPE nga OE “OES DISTRIMED” shpk nuk na vërteton se kjo pajisje mjekësore plotëson specifikimet teknike “Aspirator Neonat, Të jetë i përshtatshëm për infant, Të shoqërohet me të paktën 2 koka silikoni”, por vetëm oferton dy aksesore, kanjulat e aspirimit, apo koka silikoni (6 FR dhe 8 FR) që janë për përdorim neonatal, dhe nuk vërteton që të dy këta aksesore janë kompatibël me aparatën aspirator prodhues GIMA, modeli 28215.

KSHA sqaron se OE “OES DISTRIMED” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokument të vulosur/ të firmosur/ të certifikuar nga prodhuesi “GIMA”, që të vërtetojë që të gjitha pretendimet dhe argumentet teknike të paraqitura në ankesë, plotësojnë kërkesat teknike dhe klinike të AK, të cilat janë të domosdoshme për shërbimin shëndetsor.

Për këtë arsye, KSHA vlerëson se pretendimi i OE, për pajisjen Aspirator nuk qëndron.

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) të ngritur me urdherin e titullarit të AK QSUNT (Nr....., me nr....., për shqyrtimin dhe trajtimin e ankesës së OE “OES DISTRIMED” shpk te administruar ne AK QSUNT me nr. 2615 prot.datë 13.10.2021 për procedurën me objektin e sipërcituar, referuar në argumentet e lartpërmendura si dhe bazuar në Ligjin nr. 162 date 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, vendosi si me poshte:

- 1- Pretendimet e OE për Pajisje mjekësore: Ventilator të Kujdesit Intensiv për Kirurgji Pediatrike dhe Neonate qëndrojnë.*
- 2- Pretendimet e OE për Pajisje mjekësore: Aspirator nuk qëndrojnë.*
- 3- Të pranojë pjesërisht pretendimin e paraqitur në ankesën e tij lidhur me specifikimet teknike të artikujve të Lotit 2.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK dhe me shkresën nr. 2615/2 prot., datë 25.10.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, konkretisht citoj:

“[...]“[...]Pasi u vlerësua se operatori ka respektuar rregullat e mësipërme të parashikuara nga ligjvënësi dhe rrjedhimisht ankesa u mor në shqyrtim nga KSHA.

Lidhur me pretendimet për pajisjen: Ventilator të Kujdesit Intensiv për Kiiurgji Pediatrike dhe Neonate për specifikimin: Ekrani duhet të jetë me ekran me prekje me ngjyra LCD / TFT i integruar min 15 inç, mundësisht, të lundroni me një sëipe midis informacionit të së kaluarës, të tashmes dhe të së ardhmes (ekrani shtesë i vecantë / i shumëfishtë nuk do të jetë i pranueshëm), KSHA sqaron se bazuar në shtojcën e ngarkuar në SPE në datë 30.07.2021 si më poshtë:

ISHTE: Ekran duhet të jetë me ekran me prekje me ngjyra LCD / TFT i integruar min 15 inç, mundësisht, të lundroni me një swipe midis informacionit të së kaluarës, të tashmes dhe të së ardhmes (ekrani shtesë i vepantë / i shumëfishtë nuk do të jetë i pranueshëm).

BËHET: Ekran duhet të jetë me ekran me prekje me ngjyra LCD / TFT i integruar min 12- 15 inç, mundësisht, të lundroni me një swipe midis informacionit të së kaluarës, të tashmes dhe të së ardhmes (ekrani shtesë i veçantë / i shumëfishtë nuk do të jetë i pranueshëm).

gjithashtu, referuar katalogut për artikullin nr. 2 të paraqitur nga OE me produktin “neumovent advance”, në faqen 3, për specifikimin: Screen “size: 12.1”, pretendimi i OE “OES DISTRIMED” shpk qëndron.

Pasi u vlerësua se operatori ka respektuar rregullat e mësipërme të parashikuara nga ligjvënësi dhe rrjedhimisht ankesa u mor në shqyrtim nga KSHA.

Lidhur me pretendimet për pajisjen: Aspirator për specifikimin “Aspirator Neonat, Të jetë i përshtatshëm për infant, Të shoqërohet me të paktën 2 koka silikon”.... KSHA sqaron se pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet e OE, lidhur me vendimin e KVO për skualifikim të këtij OE, pasi nuk plotëson specifikimet teknike, të sipërcituara, dhe pas verifikimit të dokumentacionit teknik vëren se:

Për artikullin “Aspirator”, prodhues GIMA, modeli 28215, KSHA shqyrton se katalogu i vënë në dispozicion në SPE nga OE “OES DISTRIMED” shpk nuk na vërteton se kjo pajisje mjekësore plotëson specifikimet teknike “Aspirator Neonat, Të jetë i përshtatshëm për infant, Të shoqërohet me të paktën 2 koka silikon”, por vetëm oferton dy aksesore, kanjulat e aspirimit, apo koka silikon (6 FR dhe 8 FR) që janë për përdorim neonatal, dhe nuk vërteton që të dy këta aksesore janë kompatibël me aparatën aspirator prodhes GIMA, modeli 28215.

KSHA sqaron se OE “OES DISTRIMED” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokument të vulosur/ të firmosur/ të certifikuar nga prodhuesi “GIMA”, që të vërtetojë që të gjitha pretendimet dhe argumentet teknike të paraqitura në ankesë, plotësojnë kërkesat teknike dhe klinike të AK, të cilat janë të domosdoshme për shërbimin shëndetsor.

Për këtë arsye, KSHA vlerëson se pretendimi i OE, për pajisjen Aspirator nuk qëndron.

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) të ngritur me urdherin e titullarit të AK QSUNT (Nr....., me nr....., për shqyrtimin dhe trajtimin e ankesës së OE “OES DISTRIMED” shpk te administruar ne AK QSUNT me nr. 2615 prot.datë 13.10.2021 për procedurën me objektin e sipërcituar, referuar në argumentet e lartpërmendura si dhe bazuar në Ligjin nr. 162 date 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, vendosi si me poshte:

1- Pretendimet e OE për Pajisje mjekësore: Ventilator të Kujdesit Intensiv për Kirurgji Pediatrike dhe Neonate qëndrojnë.

2- Pretendimet e OE për Pajisje mjekësore: Aspirator nuk qëndrojnë.

3- Të pranojë pjesërisht pretendimin e paraqitur në ankesën e tij lidhur me specifikimet teknike të artikujve të Lotit 2.

II.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-97559-06-07-2021, me objekt “*Furnizim Vendosje Aparatura Mjekësore, Mobilimi dhe Hotelerie për Godinën e Re të Pediatrisë, Ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore*”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër (në total për të gjitha lotet): 108,245,244.67 (*njëqind e tetë milion e dyqind e dyzet e pesë mijë e dyqind dyzet e katër pikë gjashtëdhjetë e shtatë tridhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër presje pesë*) Lekë pa TVSH, **Loti 2** me Nr. REF-97566-06-07-2021 me objekt “*Pajisje anestetike dhe të Frymëmarrjes*” me fond limit/vlerë të pritshme të kontratës 9,368,517.60 (*nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri